



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-12927/22 datë: 24.05.2022



Npi – 01/125 datë: 27.05.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 27.05.2022 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 27.05.2022 (e premte) në ora 10.00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Perparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Heroina Selmani. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Shpëtim Gashi, zyrtar për informim, znj.Valmira Hoxha, praktikante.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF për vitin 2022,
2. Shqyrtimi i Listës së kërkesave Npi-01/113,
3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025,
4. Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022,
5. Propozim-Vendim për rritjen e Buxhetit të vitit 2021 për realizimin e të hyrave Vetanake,
6. Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MBPZHR,Nr.1556/3 dt.29.04.2022,
7. Propozim-Vendim për ndarjen e 100 € për Nënata Lebona për çdo fëmijë të lindur në 2022,
8. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm pronat e paluajtshme në ZK-Shtime dhe ZK-Petroviq, për projektin “Unaza e vogël e qytetit” - Shtime,
9. Propozim-Plani Lokal i Verprimit për Biodiversitet 2021-2026, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, Pajtohem me rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF për vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Idajet Rexhepit.

z.Idajet Rexhepi, bashkpuntor profesional e Kuvendit; Përshëndetje, Propozim-Vendimin për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF për vitin 2022, e keni marrë në formë të shkruar. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa janë harmonizuar me orarin e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve të tjera, por nëse ka propozime për ndonjë ndryshim, duhet marrë parasysh edhe orarin e mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve tjera.

znj.Adelina Beqaj; Sa i përket orarit të mbledhjeve është i përshtatshëm, mirëpo unë propozoj që mbledhjet të fillojnë në ora 9 e jo në 10 qysh është propozuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Vendimit për caktimin e orarit të mbledhjeve të Komitetit për Ppolitikë dhe Financa për vitin 2022, me propozimin e znj.Adelina Beqaj që ora e mbajtjes së mbledhjeve të ndryshohet nga ora 10:00h sa ishte propozuar në ora 9:00h.**

Pika 2

Shqyrtimi i Listës së kërkesave Npi-01/113

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Idajet Rexhepit.

z.Idajet Rexhepi, bashkpuntor profesional e Kuvendit; Kemi kërkesa të grumbulluara që nga viti 2019 e që i janë adresuar Kuvendit, kto kërkesa kryesisht janë kërkesa që kanë të bëjnë me emërtimin e objekteve publike. Afat ligjor për përfundimin e këtyre kërkesave ka kaluar qysh moti, sepse ato kanë vetëm një muaj afat për ti trajtuar. Këtyre kërkesave duhet me ju dhënë një epilog, ose të miratohen ose të refuzohen.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë mendoj se edhe në këtë mbledhje këto kërkesa duhet të shtyhen me qëllim që të analizohen mirë e mirë dhe të marrim rekomandimet nga drejtoritë përkatëse.

z.Përparim Ramusa; Pajtohem që emërtimet për objektet publike janë të ndieshme. Fillimisht duhet të formohet Komisioni për emërtimin e objekteve publike. Për këtë arsye kërkesat duhet me u shty, sikurse edhe ato kërkesa për emërtimin e rrugëve.

znj.Adelina Beqaj; Unë e shoh si të ngutshme kërkesën e Zhaneta Demirit. Mirëpo si anëtare e grupit joformal të grave, unë jam që ta mbështesim kërkesën e Zhaneta Demirit.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, te kërkesa me numër 13 unë mendoj se kërkesa duhet të adresohet te Drejtoria për Shërbime Publike. Te kërkesa me numër 14 e Avni Dugollit, ky nuk e përfaqëson lagjen Dugolli. Unë i kam pa se ata po i rrethojnë varrezat, është individuale.

z.Përparim Ramusa; Propozoj që kërkesat për emërtimin e objekteve publike dhe emërtimin e rrugëve, si dhe kërkesa me numër 11 që ka të bëjë me anulimin e vendimit për pronat që u janë dhënë bizneseve në shfrytëzim në fshatin Davidovc, të shtyhen.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, edhe unë jam për me u shty dhe për me u analizuar më mirë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, të miratoi Konkluzionin për shtyrjen e shqyrtimit të Kërkesave 1 deri 7, 10, 11, dhe 16, me arsyetimin që: 1.Të analizohen më mire, 2.Të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi, 3. Të formohen Komisionet përkatëse për trajtimin e tyre.**

8. z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z.Kemal Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr."Hamëz Jashari" p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-19162/20 datë:24.09.2020.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E lexoi kërkesën dhe hapi diskutimin.

z.Përparim Ramusa; Edhe për këtë kërkesë unë propozoj për me u shty, me qëllim që ne me pas informacione më të sakta.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, të miratoi Konkluzionin për shtyrjen e shqyrtimit të Kërkesës së z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, me arsyetimin që 1. Të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi, 2. Kërkesa të kompletohet me informacione të sakta.**

9. z.Bekim Osmani – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-19428/20 datë:29.09.2020,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E lexoi kërkesën dhe hapi diskutimin.

z.Përparim Ramusa; Ka kërkesa që janë të ndieshme. Nuk kemi rekomandim të Kryetarit, prandaj unë propozoj që të shtyhet.

z.Lumni Amrushi; Nëse është paraparë që ai lokacion me u futë nën mbrojtjen e Agjensionit për mbrojtjen e monumenteve, unë propozoj që ta marrim një vendim për të gjitha rastet e jo individualisht.

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, të miratoi Konkluzionin për shtyrjen e shqyrtimit të Kërkesës së z.Bekim Osmanit nga fshati Raçak, me arsyetimin që 1. Të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi.

12. znj.Zhaneta Demiri – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-6353/22 datë:07.03.2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E lexoi kërkesën dhe fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Kjo kërkesë nuk është e përfshirë në propozimin tonë, për harmonizimin e subvencioneve. Kjo duhet të diskutohet në Kuvend.

z.Lumni Amrushi; A egziston mundësia që me u bë një nënkod financiar për atë që ka propozuar Zhaneta, pyetje për, Bujar Feratin, zyrtar kryesor financiar?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Nuk ki nevojë për kurrfar nënkodi, Konkurojnë sikur të tjerët për Subvencione dhe nëse i marrin mirë.

znj.Adelina Beqaj; Unë po mendoj se më mirë është me ju ndihmuar këtyre grave, nëse munden me u marrë 10 mijë euro te kodi mallra dhe Shërbime.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Ne i kemi kërkesat tona të drejtorive, dhe unë deri tani nuk kam qenë në dijeni për këtë kërkesë, kështu që më mirë e ka pas ajo me ju drejtu drejtorisë përkatëse. Unë po mendoj se kjo më mirë është për me u planifikuar te drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

z.Përparim Ramusa; Kemi mjete bukur shumë për bartje, a kemi mundësi ligjore me i marrë te arsimi, te administrata e te të gjitha ngapak dhe me e bërë fondin.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Ne jemi munduar që ti ballancojmë financat nëpër drejtori për mos me na i kthyer vendimin Ministria. Drejtoria i ka edhe 37 mijë euro, prandaj unë po mendoj se kërkesa duhet me u adresuar te Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

z.Kadri Emiri; Përsëritet, Bujari e elaboroi mirë këtë çështje, sa po shoh unë 15 mijë euro drejtoria ka mundësi me i destinuar për këtë çështje.

z.Lumni Amrushi; Drejtoria mundet me bërë një thirrje publike për këtë pjesë. Ndërsa për pjesën tjetër me zhvillu procedura si zakonisht.

z.Përparim Ramusa; Unë propozoj që t'i rekomandojmë Kuvendit që kërkesa të adresohet te DZHE dhe që drejtoria, brenda mundësive ta ndihmoi kërkesën e Zhaneta Demirit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, që kërkesa e znj.Zhaneta Demirit nga Shtimja, të Transferohet në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, dhe drejtorisë i Rekomandon që Brenda mundësive ta ndihmoi financiarisht.**

13. z.Ikrem Bajrami – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-1076/22 datë: 21.04.2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E lexoi kërkesën dhe hapi diskutimin.

z.Lumni Amrushi; Unë propozoj që kërkesa të transferohet në Drejtorinë për Shërbime Publike.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, që kërkesa z.Ikrem Bajramit nga fshati Reçak të Transferohet në Drejtorinë për Shërbime Publike, për shqyrtimin e sajë.**

14. z.Avni Dugolli – Pjetërshticë, Kërkesa Nr.01-070/05-10327/22 datë: 22.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E lexoi kërkesën dhe hapi diskutimin.

z.Lumni Amrushi; Unë propozoj që të shtyhet me qëllim që ne ta kemi listen, ose kërkesën komplet të skanuar për Kuvend.

z.Kadri Emini; Propozoj që të shtyhet, me qëllim që ta kemi rekomandimin e drejtorisë - DPUKGJ.

z.Lumni Amrushi; Tërhiqem nga propozimi im.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, të miratoi Konkluzionin për shtyrjen e shqyrtimit të Kërkesës të z.Avni Dugolli nga fshati Pjetërshtic me arsyetimin që 1. Të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi.**

15. z.Gani Ademaj – Petrovë, Ankesë Nr.01-070/05-10354/22 datë: 22.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E lexoi kërkesën dhe hapi diskutimin.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, që kërkesa e z.Gani Ademaj nga fshati Petrovë të Refuzohet me arsyetimin se në fshatin Petrovë po zhvillohet një debat publik për sa i përket caktimit të Lokacionit për Çerdhe.**

Pika 3

Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Siç e dini për ç'do vit e kemi për obligim që ta diskutojmë dhe shqyrtojmë KAB-in, këtë herë e kemi përt periudhën 2023-2025. Kjo siç dihet duhet të shkojë në diskutim publik. Materialin e keni marrë dhe e keni lexuar, por unë po i lexoi vetem të dhënat kryesore sipas tabelave nga draft dokumenti, (shih dokumentin). Në fund nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

z.Përparim Ramusa; Nuk kam ndonjë pyetje, kjo ka me dalë në debat publik dhe unë e përkrahu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse kjo shkon direkt në diskutim publik, atëherë po e qes në votim, dhe në vazhdim konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025.**

Pika 4

Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Propozim-vendimin e keni marrë dhe e keni lexuar, mirëpo unë po i lexoj edhe një herë të gjitha shumat e propozuara për ata që nuk e kanë lexuar dokumentin, totali i shumës që ka me u transferuar është 307,384.53€ (shih dokumentin).

z.Përparim Ramusa; 50 mijë euro janë për renovimin e shkollave, a e keni listën se cilat shkolla kanë me u renovuar.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Shenimet e sakta i jep kontrata për renovimin e shkollave në Shtime, por më në detaje i jep Drejtoria e Arsimit ose Drejtoria e Prokurimit.

z.Përparim Ramusa; Propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit që të kalojë kjo pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, aprovimin e Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2021 në vitin 2022, ashtu si janë planifikuar nga ZKF-ja.**

Pika 5

Propozim-Vendim për rritjen e Buxhetit të vitit 2021 për realizimin e të hyrave Vetanake
Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Nga grumbullimi i të hyrave në vitin e kaluar e kemi tejkaluar buxhetin, kështu që kufiri (tavani) është rritur, kështu që për me mujt me i shfrytëzuar ne këro mjete të të hyrave vetanake ne duhet me marrë vendim për me rritë tavanin e Buxhetit për 2021. Ju ftoj që ta miratoni këtë vendim, sepse është një çështje krejtësisht formale, nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

znj.Adelina Beqaj; A është rritja e buxhetit vetëm për vitin 2021 apo prekë edhe vitin 2022?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Niveli i të hyrave në vitin 2022 është në rritje, mirëpo ne këtu në këtë pikë po flasim vetëm për vitin 2021.

z.Përparim Ramusa; E mbështesim këtë propozim, dhe i përgëzoj qytetarët për përgjigjen e tyre në pagesën e tatimeve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, aprovimin e Vendimit për rritjen e Buxhetit të vitit 2021 për realizimin e të hyrave Vetanake.**

Pika 6

Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MBPZHR,Nr.1556/3 dt.29.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fillimisht Kryesuesi e sqaroi kërkesën e Ministrisë së Bujqësisë për ta plotësuar rregulloren për taksa për vitin 2022. Në vazhdim për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Kte unë mendoj se duhet me e elaboruar mirë me qëllim që mos me na ardhë me vonesa më kërkesa të tilla nga ministrinë të ndryshme. Unë mendoj se nuk ka ndonjë problem që këto nene që i ka përmendur Ministria e Bujqësisë me i inkorporu në rregulloren tonë për taksa.

z.Përparim Ramusa; Propozoi që ti rekomandojmë Kuvendit miratimin e vendimit për futjen e neneve që i ka përmendur Ministria e Bujqësisë në Rregulloren komunale për taksa për 2022.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, aprovimin e Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MBPZHR,Nr.1556/3 dt.29.04.2022.**

Pika 7

Propozim-Vendim për ndarjen e 100 € për Nënat Lehona për çdo fëmijë të lindur në 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Fillimisht, kemi marrë vendim për ndarjen e 100€ për nënat lehona, kështu që propozoj që t'i rekomandojmë Kuvendit aprovimin e këtij vendimi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, aprovimin e Vendimit për ndarjen e 100 € për Nënata-Lehona për çdo fëmijë të lindur në vitin 2022.**

Pika 8

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm pronat e paluajtshme në ZK-Shtime dhe ZK-Petroviq, për projektin "Unaza e vogël e qytetit" - Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj. Adelina Beqaj; Ka pas diskutim për këtë pikë, dhe ne mendojmë se kjo është një temë e gjërë dhe duhet me u diskutu gjatë në Kuvend. Unë i propozoj KPF-së që mos me dhënë rekomandim.

z. Kadri Emini; Edhe unë mendoj që të shkojë në Kuvend pa rekomandim, kështu që në mbledhjen e Kuvendit me ardhur drejtori dhe me na dhënë sqarime sa më shumë.

znj. Adelina Beqaj; Edhe unë mendoj se drejtori duhet me ardhë në mbledhjen e Kuvendit dhe me na dhënë sqarime sa më shumë, sepse është projekt me rëndësi.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi se nuk ka Rekomandim për këtë pikë, me arsyetimin se është temë e gjërë dhe duhet të debatohet gjerësisht për te.

Pika 9

Propozim-Plani Lokal i Verprimit për Biodiversitet 2021-2026, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj. Adelina Beqaj; Unë propozoi që këtë pikë ta kalojmë me rekomandim pozitiv për Kuvendin.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, aprovimin e Planit Lokal të Verprimit për Biodiversitet 2021-2026.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:50h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi